



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 46 Prot.

Tiranë, më 14.01. 2025

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 9, datë 14.01 2025

PËR

**KRIJIMIN E GRUPIT TË GATSHËM DHE ORGANIZIMIN E PROCESIT TË
MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL ME OBJEKT
VEPRIMTARIE EMËRIMET E REJA DHE SJELLJA E NËPUNËSVE CIVILË GJATË
PROCESIT ZGJEDHOR**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në nenin 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; në Rregulloren e Procedurave të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe kërkesën e Kuvendit të Shqipërisë për të monitoruar sjelljen e nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore 11.04.2025 deri 11.05.2025, në kushtet e zgjedhjeve të përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë,

URDHËRON :

1. Ngritjen e grupit të gatshëm me objekt veprimtarie monitorimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me fokus emërimet e reja dhe sjelljen e nëpunësve civile gjatë fushatës zgjedhore, nëpërmjet: a) koordinimit të punës për të mbledhur informacionin nga grupet e monitorimit që do të ngrihen në të gjitha institucionet që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil; b) nëpërmjet sondazheve të kryera në institucione, si dhe c) nëpërmjet verifikimit të informacioneve, apo denoncimeve të ardhura nga subjekte të ndryshme, si dhe nga media.
2. Në përbërje të këtij grupi do të jenë 15 inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, si dhe drejtuesit e strukturave që përbëjnë këtë drejtori, të cilët janë, Drejtori i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ; Drejtori i Mbikëqyrjes dhe Drejtori i Zbatimit të

procedurën e komunikimit dhe me masat që duhet të marrin për ta përmbyllur atë me sukses.

5. Të komunikohet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për të vendosur pikat e kontaktit me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen e këtij institucioni në veprimtarinë e tij gjatë periudhës zgjedhore.
6. Të hartohen të gjitha aktet e nevojshme për procesin dhe të njoftohen institucionet në lidhje me to.
7. Gjatë procesit, të propozohen akte unifikuese apo qëndrime që duhet të mbajë Komisioneri në lidhje me zhvillime të ndryshme që do të evidentohen gjatë fushatës.
8. Të hartohet një plan veprimi, nëpërmjet të cilit të ndahen subjektet dhe inspektorët përkatës që do të jenë pika kontakti midis tyre.
9. Të informohet Komisioneri në përfundim të ditës, përgjatë gjithë fushatës zgjedhore, në lidhje me ecurinë e procesit të monitorimit, nëse ka problematika të evidentuara.
10. Në përfundim të mbikëqyrjes do të hartohet raporti i monitorimit të procesit, i cili do t'i njoftohet Kuvendit të Shqipërisë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet.
11. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes; Drejtoria e Çështjeve Ligjore; si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
12. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të sigurojë mbështetjen e grupit të gatshëm me asistencë ligjore, si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikën e nevojshme, për vijimin normal të procesit.
13. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që, nëpërmjet specialistit të arkiv-protokollit, të njoftojë të gjithë anëtarët e grupit të punës, si dhe drejtoritë përkatëse të ngarkuara me zbatimin e këtij urdhri.
14. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI
Pranvera Strakosha

